



# PROGRAMI I PUNËS PRAKTIKE

**Kosovo Generation Unlimited (K-GenU)** është një koalicion shumë-sektorial për bashkëpunim, me qëllim të rritjes së investimeve për dhe me të rinjtë, që ata të mund të shfrytëzojnë dhe rrisin potencialin e tyre. Përmes bashkëpunimit në mes të institucioneve qeveritare, partnerëve zhvillimorë, akterëve e sektorit privat, dhe organizatave e shoqërisë civile K-GenU fuqizon dhe angazhohet me të rinjtë duke i lidhur ata me mundësi për të përmirësuar apo lehtësuar kalimin e tyre nga shkolla në punë, përmes programit të punës praktike. Ky program shoqërohet me trajnime për zhvillimin e aftësive dhe mentorim për të lehtësuar pervojën e të rinjve në tregun e punës.

Përmes bashkëpunimit në mes të institucioneve qeveritare, partnerëve zhvillimorë, akterëve të sektorit privat, dhe organizatave e shoqërisë civile, K-GenU fuqizon dhe angazhohet me të rinjtë duke i lidhur ata me mundësi për të përmirësuar apo lehtësuar kalimin e tyre nga shkolla në punë.

## Me angazhimin në programin e punës praktike K-GenU, të rinjtë përfitojnë mundësi:



Të ndërtojnë CV-në e tyre



Të lidhen me entitete të sektorit publik dhe privat



Të angazhohen në punë praktike tre-mujore – me kompensim financiar, duke u bazuar në fushën e tyre të interesit



Të ju caktohen mentorë për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen përgjatë rrugëtimit të tyre



Të përfitojnë nga mundësitë e trajnimit dhe qasje në qendër tonë të burimeve

## Ndërsa, përparësitë e angazhimit të partnerëve në programin Kosovo Generation Unlimited përfshijnë:

Qasjen në CV-të e mijëra të rinjve nga e gjithë Kosova, të interesuar për angazhim në punë praktike

Bashkë-kompensimin e shpenzimeve të praktikantëve të angazhuar në entitetet e tyre.

Kontribum në avancim dhe fuqizim të të rinjve Kosovar.